



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izhorni Panel za žalbe i Predstavke

Anr.188/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Vlerona Maliqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Organizatës Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së materialit promovues në hapësirë publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 06 tetor 2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 04.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.188/2019 e datës 02.10.2019, e paraqitur nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së materialit promovues në hapësirë publike.

A r s y e t i m

Me datë 02.10.2019, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, me të cilën pretendon se më datë 01.10.2019, rreth orës 13:00, në Komunën e Prizrenit, në afërsi të shkollë fillore “Abdyl Frashëri”, në lagjen Ortakoll, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), është vendosur material promovues i kandidatit për deputet nga radhët e këtij subjekti politik, Xhavit Ukaj, veprim ky i cili sipas tyre bie në kundërshtim Rregullën Zgjedhore Nr.13/2013, për “Fushatën e Zgjedhjeve dhe Njoftimin për Ngjarjet Politike”, respektivisht dispozitën e nenit 3 par.3, pika 4, të kësaj Rregulle zgjedhore, në të cilën në mënyrë shprehimore tregohet se ndalohet vendosja e materialit promovues në perimetër prej 100 metrave nga institucionet publike. Në fund ka shtuar se pavarësisht faktit se komuna i ka paraparë si vende në të cilat mund të vendosen materialet promovuese, këto materiale janë vendosur në afërsi të shkollës fillore dhe si të tilla, janë në kundërshtim me ligjin dhe rregulloret në fuqi. Ankuesi si dëshmi për pretendimet e tij, ankesës i ka bashkangjitur dy fotografi të printuara në cilësi të provave materiale.

Në përgjigje në ankesë të datës 03.10.2019, subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ka theksuar se ankesa është e pabazuar, për faktin se në kushtet dhe rrethanat në të cilat është duke u zhvilluar fushata zgjedhore, duke pasur parasysh faktin se komunat nuk kanë arritur që të krijojnë hapësira të veçanta për vendosjen e materialeve zgjedhore, ashtu siç kërkohet me dispozita ligjore, vendosja e materialeve në hapësira 20-30 metra, larg hapësirës së shkollës “Abdyl Frashëri”, në Prizren, nuk përbën shkelje të LZP-së dhe rregullave zgjedhore. Në fund ka njoftuar se nga ana e subjektit politik LDK, megjithatë janë ndërmarrë veprime për përmirësimin e shkeljes, ashtu që është larguar fotoja e kandidatit për deputet, gjë të cilën e provojnë fotot e bashkangjitura me rastin e plotësimit të përgjigjes në ankesë.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli, vlerëson se pretendimet e paraqitësit të ankesës janë të pabazuara, dhe nuk përbëjnë shkelje të Rregullës Zgjedhore Nr.13/2013, siç pretendohet në ankesë, sepse posteri i kandidatit për deputet nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), është vendosur në vendin e dedikuar për reklamim të materialit propagandistik për fushatë zgjedhore.

Lidhur me pretendimet e parashtruesit të ankesës se posteri i kandidatit në fjalë, është vendosur në afërsi të institucioneve publike, përkatësisht në distancë prej 20-30 metrash larg shkollës fillore “Abdyl Frashëri” në Prizren, Paneli vlerëson se në një rast të tillë, ky veprim, në këtë kohë, nuk përbën shkelje të Rregullës zgjedhore të sipërcituar, për faktin se sipas Rregullës Zgjedhore, Nr.13/2013, për “Fushatën e Zgjedhjeve dhe Njoftimin për Ngjarjet Politike”, në nenin 1, ndër të tjera përcaktohet se: *“Kjo rregullore ka për qëllim të rregullojë: organizimin dhe mbajtjen e tubimeve publike, përmbajtjen e materialeve të shtypura të fushatës zgjedhore, rastet e veprimeve para ditës së zgjedhjeve ...”*, nga kjo rezulton se këto veprime të subjektit në fjalë nuk janë në kundërshtim me dispozita ligjore siç pretendon paraqitësi i ankesës ngase këto veprime janë të ndaluara vetëm para fillimit të votimit dhe gjatë ditës së votimit, nëse objekti afër të cilit pretendohet se është vendosur posteri, shërben si Qendër e Votimit, ku sipas nenit 85 paragrafi 1 të LZP-së, përcaktohet se: *“Të gjitha subjektet politike të cilat nuk kanë larguar materialet e fushatave të tyre zgjedhore të vendosura brenda dhe rreth cilitdo VV ose QV në rreze prej 100 metra, çfarëdo materiali i tillë i mbetur 24 orë para fillimit të votimit duhet të largohet nga anëtarët e KVV-ve ose Menaxheri i QV-së. Subjektet politike të cilat nuk kanë larguar dhe/ose janë gjetur duke postuar material të fushatës zgjedhore pas afatit kohor të vendosur duhet të raportohen në PZAP për shkelje të këtij ligji”*.

Nga arsyet e theksuara më lartë, e duke u bazuar në nenin 115 par.1 dhe nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr. 188/2019 më datë 04.10.2019

Kryesues i Panelit
Adnan Konushevc



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.